# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5640
E enjte, 29 nëntor 2019
çmimi 0.40 €


## Thaçi thotë se mbështetja e ShBA-së për marrëveshjen Kosovë - Serbi është unike



FAQE 2


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


### TIRANA, PRISHTINA DHE SHKUPI FESTOJNË 28 NËNTORIN

# SHQIPTARËT, FAKTOR I RËNDËSISHËM POLITIK NË BALLKAN



28 Nëntori, Dita e Flamurit, ka vazhduar të festohet në Kosovë, edhe pse kjo datë nuk bën pjesë në kalendarin e festave zyrtare në vend. Si çdo vit, 28 nëntori Prishtinën e ka gjetur të stolisur me flamurin kuq e zi, kurse qytetarët kanë festuar nëpër sheshe dhe lokale të ndryshme të kryeqytetit. Megjithatë, festa më e madhe kombëtare nuk i ka bashkuar liderët politikë të vendit. Ndonëse të gjithë i kanë uruar shqiptarët për këtë festë, ata të ndarë kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz dhe te varret e shumë dëshmorëve dhe heronjve të kombit shqiptar. 28 nëntori me ceremoni të ndryshme është festuar edhe në Tiranë dhe në Shkup, në të cilët është përcjell mesazhi se sot shqiptarët janë faktor i rëndësishëm politik në Ballkan FAQE 3

## AKTUALE

### TË GJITHË MBROJNË KRIMIN E ORGANIZUAR, SI 'UNMIV-i' '(I VERIUT)' DHE BE-JA?! F. 12



Nga Jakup KRASNIQI

### SERBISË S'DUHET T'I JEPET ASGJË! F. 12



Nga Shemsi SYLA

### SHKON SALVATORE CUOCI, VJEN LORENZO D'ADDARIO F. 7



## Dorëheqjet e kryetarëve serbë, demonstrim i shkëputjes së veriut nga administrimi i Kosovës FAQE 4.5



FLET PËR "EPOKËN E RE" GUVERNATORI I BQK-SË, FEHMI MEHMETI

## Duhet të ketë rënie të normave të interesit në institucionet mikrofinanciare FAQE 8



## EKONOMI

### BANKAT NË KOSOVË, TË RREZIKUARA NGA GRUPET E ARMATOSURA KRIMINALE F. 9

## KULTURË

### YLLKA R. IMERI KA BOTUAR LIBRIN 'REP MUSIC LANGUAGE' F. 17

## SPORT

### '89-SHI ELIMINOI LLAPIN NGA KUPA F. 18




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Presidenti Trump uron Shqipërinë për 106-vjetorin e Pavarësisë

TIRANË, 28 NËNTOR -Mesazhe të shumta urimi me rastin 106-vjetorit të Ditës së Pavarësisë dhe të Flamurit kanë ardhur nga të gjitha anët e botës, e shumë liderë botërorë.
Me rastin e 106-vjetorit të Ditës së Pavarësisë dhe të Flamurit, presidenti i Republikës, Ilir Meta, ka marrë mesazhe të shumta urimi nga krerë shtetesh të vendeve mike e partnere të Shqipërisë.
"Jemi krenarë për marrëdhënien e fortë që dy kombet tona kanë zhvilluar dhe arritjet domethënëse që kemi realizuar së bashku. Shqipëria është një aleate e vyer, që ka dhënë një kontribut domethënës për sigurinë rajonale dhe atë globale", thuhet në mesazhin e presidentin amerikan Donald Trump
Edhe Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo në mesazhin e tij shprehet se ShBA-ja e vlerëson angazhimin e Shqipërisë në NATO dhe në koalicionin global për mposhtjen e ISIS-it, që kontribuon në stabilitetin dhe paqen e gjithë botës.
"Ne i përshëndesim përpjekjet e vazhdueshme të Qeverisë së Shqipërisë në drejtim të reformës në drejtësi dhe ndërtimit të institucioneve të forta demokratike dhe ne mbështesim hapat e rëndësishëm të Shqipërisë drejt integrimit perëndimor", thuhet në mesazhin e urimit të sekretarit Pompeo.

# Thaçi thotë se mbështetja e ShBA-së për marrëveshjen Kosovë - Serbi është unike

**Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në kuadër të vizitës zyrtare në ShBA, është takuar të mërkurën edhe me senatorin amerikan, Ron Johnson. Pa këtij takimi, Thaçi ka bërë me dije se është një mbështetje unike e të gjitha institucioneve të ShBA-së për arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që siguron njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në NATO, BE dhe OKB**



"Epoka e re"

UASHINGTON, 28 NËNTOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në kuadër të vizitës zyrtare në Shtetet të Bashkuara të Amerikës (ShBA), është takuar të mërkurën me senatorin amerikan Ron Johnson, me të cilën ka biseduar për tema të cilat janë në interes të dy vendeve, me theks të veçantë për dialogun Kosovë - Serbi. "Në Senatin e ShBA-së takova edhe senatorin Ron Johnson, me të cilin biseduam për shumë tema me interes të dy shteteve tona. Është një mbështetje unike e të gjitha institucioneve të ShBA-së për arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që siguron njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në NATO, BE dhe OKB", ka shkruar të mërkurën Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".
Në ditën e dytë të vizitës zyrtare në Uashington, presidenti Thaçi ka zhvilluar një takim me John Boltonin, këshilltarin për Siguri Kombëtare të presidentit të ShBA-së, Donald Trump. Në këtë takim është biseduar për marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve, për perspektivën euroatlantike dhe për domosdoshmërinë e arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si parakusht për paqe dhe stabilitet afatgjatë në rajon. Presidenti Thaçi e ka falënderuar këshilltarin John Bolton për mbështetjen që presidenti Trump po i jep Kosovës në të gjitha fushat.
Ndërkaq këshilltari për Siguri Kombëtare i presidentit Trump e ka siguruar presidentin e Kosovës se Shtëpia e Bardhë dhe administrata Trump e mbështetin fuqishëm arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.
Thaçi në ditën e parë të vizitës së tij zyrtare në ShBA është takuar me sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo, me të cilin ka biseduar për çështje bilaterale, rajonale dhe më gjerë. Ai e ka falënderuar sekretarin Pompeo për mbështetjen e administratës Trump për Kosovën dhe për mbështetjen historike që populli amerikan i ka dhënë popullit të Kosovës. "Kam shprehur konsideratën më të lartë në emrin tim dhe të popullit të Kosovës, për çdo gjë që ShBA-ja ka bërë për lirinë e popullit tonë dhe paqen në rajon. Përjetësisht do të jemi mirënjohës", ka thënë presidenti Thaçi.
Në këtë takim është biseduar edhe për mandatin e ri të FSK-së, si një forcë shumetnike dhe për bashkëpunimin rajonal dhe perspektivën euroatlantike të Kosovës. Presidenti Thaçi, po ashtu, e ka falënderuar sekretarin Pompeo për mbështetjen që i ka dhënë procesit të transformimit të FSK-së në forcë të armatosur. "Kosova si shtet sovran ka të drejtë sovrane dhe detyrim t'i ngrehë kapacitetet e sigurisë. Tani është koha që nga konsumues, të bëhemi kontribues të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë", ka shtuar ai.
Presidenti Thaçi dhe sekretari Pompeo, po ashtu, kanë biseduar për fazën e fundit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "ShBA-ja e mbështet Kosovën për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Serbinë, e cila i hap rrugë njohjes reciproke dhe anëtarësimit të Kosovës në NATO, BE dhe OKB", ka thënë presidenti Thaçi.
Mbështetja e ShBA-së, sipas presidentit Thaçi, është përcaktues për arritjen e kësaj marrëveshjeje dhe krijimin e një konsensusi më të madh brenda dhe jashtë Kosovës. "Ishte konkludim i përbashkët se nëse nuk e shfrytëzojmë këtë momentum historik, ne rrezikojmë të hyjmë në një cikël të rrezikshëm jo vetëm si Kosovë, por edhe si rajon. Prandaj, mënyra e vetme për ta mbyllur njëherë e përgjithmonë çështjen e Ballkanit është arritja e një marrëveshjeje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë", ka thënë presidenti Thaçi.
Ndërsa sekretari i Shtetit amerikan, Mike Pompeo, ka theksuar se ShBA-ja do ta vazhdojë mbështetjen e Kosovës, me theks të veçantë arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obliguese ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

## Gjermania kritikon Kosovën dhe Serbinë, bën thirrje për dialog

BERLIN, 28 NËNTOR - Qeveria e Gjermanisë u bëri thirrje qeverive të Kosovës dhe të Serbisë që të shmangin përshkallëzimin e tensioneve midis tyre dhe t'i rikthehen dialogut.
Zëdhënësi Steffen Seibert kritikoi edhe fushatën e Serbisë për të penguar anëtarësimin e Kosovës në agjencinë ndërkombëtare të policisë, Interpol, edhe Kosovën për vendosjen e taksës 100% mbi prodhimet e importuara nga Serbia.
"U bëjmë thirrje të gjitha palëve që të shmangin përshkallëzimin", tha Seibert në Berlin, duke shtuar se normalizimi i marrëdhënieve Serbi-Kosovë është parakusht për bisedimet e pranimit të Serbisë në Bashkimin Evropian, raporton DPA.
Qeveria në Prishtinë ka fajësuar, siç ka thënë, "fushatën e egër" të Serbisë për të penguar anëtarësimin e Kosovës në Interpol, gjatë një votimi që është mbajtur këtë muaj.
Autoritetet kosovare, javën e kaluar, kanë rritur nga 10% në 100% taksën mbi prodhimet e importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Tirana, Prishtina dhe Shkupi festojnë 28 nëntorin

# Shqiptarët, faktor i rëndësishëm politik në Ballkan

28 Nëntori, Dita e Flamurit, ka vazhduar të festohet në Kosovë, edhe pse kjo datë nuk bën pjesë në kalendarin e festave zyrtare në vend. Si çdo vit, 28 nëntori Prishtinën e ka gjetur të stolisur me flamurin kuq e zi, kurse qytetarët kanë festuar nëpër sheshe dhe lokale të ndryshme të kryeqytetit. Por, festa më e madhe kombëtare nuk i ka bashkuar liderët politikë të vendit. Ndonëse të gjithë kanë uruar shqiptarët për këtë festë, ata të ndarë kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz dhe te varret e shumë dëshmorëve dhe heronjve të kombit shqiptar. 28 nëntori me ceremoni të ndryshme është festuar edhe në Tiranë dhe në Shkup, në të cilët u përcoll mesazhi se sot shqiptarët janë faktor i rëndësishëm politik në Ballkan



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Republika e Kosovës e ka festuar 28 Nëntorin, Ditën e Flamurit, ani pse kjo festë ende nuk ka hyrë në kalendarin e festave zyrtare. Derisa qytetarët kanë festuar në mënyra të ndryshme nëpër rrugët dhe sheshet e stolisura me flamurin kuq e zi, liderët institucionalë dhe partiakë të Kosovës kanë uruar gjithë shqiptarët për këtë festë.

Në mesazhet e tyre ata kanë lartësuar këtë festë kombëtare, duke e vlerësuar 28 nëntorin si datën më të lavdishëm të historisë sonë kombëtare. Ndonëse Dita e Flamurit njihet si datë që i bashkoi shqiptarët, liderët politikë në mënyrë të ndarë kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz dhe te varret e shumë dëshmorëve dhe heronjve të kombit shqiptar.

Kjo festë presidentin Hashim Thaçi e ka gjetur në ShBA, ku po qëndron për një vizitë zyrtare. "Sot është dita më e madhe dhe më e rëndësishme në historinë e kombit shqiptar. Është 28 Nëntori i Skënderbeut. Është 28 Nëntori i Ismail Qemalit e Isa Boletinit, i UÇK-së dhe Adem Jasharit. Shumë atdhetarë dhe veprimtarë tanë kanë dhënë jetën për 28 nëntorin dhe flamurin kombëtar. Kjo është dita e tërë shqiptarëve, kudo që gjenden ata. Jam i lumtur që emocionet e kësaj dite do t'i ndaj sot me bashkatdhetarët tanë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Urime të gjithëve kjo ditë e madhe!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka zgjedhur që këtë festë kombëtare ta hapë duke bërë nderime te Kulla e Isa Boletinit në Mitrovicë. "Çdo 28 nëntor ne ngjitemi në këtë kodër historike, sepse këtu, në këto male të Shalës, këtu në konakun e Isa Boletinit, i ka rrënjët liria jonë kombëtare. Isa Boletini ishte njeri i pushkës dhe i fjalës. Ishte shembëlltyrë e tolerancës dhe e bashkëjetesës ndëretnike. Për Isa Boletinin patriotizmi nuk nënkuptonte urrejtjen dhe mohimin e të tjerëve që janë ndryshe", ka thënë Veseli.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka uruar të gjithë shqiptarët, duke thënë se kjo festë i mban bashkë shqiptarët. "Sot jemi një në zemër ashtu siç ishim e do të jemi gjithmonë. Dita e Flamurit shënon rimëkëmbjen tonë, na kujton nëpër shekuj se kush jemi dhe na mban bashkë si komb. Në këtë ditë të veçantë, që koincidon me daljen në skenë të UÇK-së dhe ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari, kujtojmë sakrificën e shumë brezave dhe nderojmë veprën e të rënëve në kohë e përpjekje të ndryshme për liri, pavarësi e dinjitet kombëtar. 28 nëntori i bekuar është historia jonë e lavdishme dhe synimi ynë për të ardhmen e përbashkët në vlerën euroatlantike", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Për kryetarin e Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, 28 nëntori mbetet muaji më i lavdishëm i historisë sonë kombëtare. "Nëntori mbetet muaji më i lavdishëm i historisë sonë kombëtare. 28 nëntori i flamurit tonë kombëtar do të jetë përherë frymëzim për të gjithë shqiptarët ndër breza. Sot shqiptarët anekënd botës festojnë 106-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari si dhe daljen e parë publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë ditë të shënuar ne sot kujtojmë të gjithë ata që sakrifikuan dhe i shërbyen kësaj dite në etapa të ndryshme", ka thënë Limaj.

Me rastin e 28 nëntorit një delegacion i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i kryesuar nga sekretari i përgjithshëm, Ismet Beqiri, ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. "Në vendin historik në Prekaz. Akti i flijimit të familjes Jashari për lirinë dhe pavarësinë tonë është shembull dhe frymëzim për gjeneratat e reja për ta dashur, ndërtuar dhe fuqizuar shtetin tonë. Lavdi!", është thënë në njoftimin e LDK-së.

Kurse lideri i Lëvizjes Vetëvendosje!, Albin Kurti, së bashku me dhjetëra aktivistë të kësaj lëvizje, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur lule te varrezat e Jasharave. "28 nëntori është dita thelbësore e identitetit kombëtar dhe historisë së shqiptarëve. Nga Skënderbeu në Krujë tek Ismail Qemali në Vlorë dhe tek Adem Jashari në Prekaz, kujtojmë ngjarjet e lavdishme dhe njerëzit e mëdhenj me ndjenjën e përbashkët të krenarisë dhe përgjegjësisë tash kur amaneti i tyre na e ndriçon rrugën përpara. Të gjithë shqiptarëve, urime dhe gëzuar 28 nëntori i flamurit, i pavarësisë dhe i UÇK-së!", ka thënë Kurti.

Për nder të kësaj dite, edhe aktivistë të Partisë Socialdemokrate kanë bërë nderime te Kompleksi Memorial "Adem Jashari", te varrezat e dëshmorëve të Komunës së Prishtinës, pranë shtatores së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu si dhe te shtatorja e Ismal Qemalit dhe Zahir Pajazitit.

Me ftesë të kryetarit të BDI-së, Ali Ahmeti, zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka marrë pjesë të mërkurën në ceremoninë e shënimit të festës së 28 nëntorit në Shkup. Hoxhaj në fjalën e tij ka theksuar se kjo festë është sa kthim prapa në histori, po aq edhe reflektim i së ardhmes. Një festë që flet për rrugën e vështirë të shqiptarëve në histori, por edhe për triumfet e shënuara. Shqipëria u bë e pavarur më 1912, por kjo fitore nuk ishte e plotë, pasi një pjesë e madhe e shqiptarëve mbetën jashtë kufijve. Ajo u bë e plotë vetëm me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Por, kemi edhe një triumf tjetër të shqiptarëve, pasi u mundësua arritja e marrëveshjes së Ohrit (2011) e cila avancon pozitën e shqiptarëve në Maqedoni dhe asaj të Prespës (2018) e cila avancon pozitën e Maqedonisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Sot shqiptarët janë faktor i rëndësishëm politik në Ballkan. Një faktor që çdoherë i ka kontribuuar stabilitetit të rajonit dhe orientimit properëndimor. Urime 28 nëntori gjithë shqiptarëve!", ka thënë Hoxhaj.





## 28 nëntori bashkon Ramën dhe Metën

Qeveria shqiptare 106-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe Ditën e Flamurit i ka shënuar me një ceremoni zyrtare në qytetin e Vlorës, ku ishte i pranishëm edhe presidenti i Republikës, Ilir Meta. Në ngritjen simbolike të flamurit në sheshin e "Pavarësisë", Qeveria e Kosovës ishte e përfaqësuar me zëvendëskryeministrin e parë dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.

Më pas, zyrtarë të lartë shtetërorë kanë vendosur kurora me lule në varrin e Ismail Qemalit. I vetmi që foli pas ceremonisë ishte presidenti Ilir Meta. "Emocion i veçantë të merrja pjesë sot në Vlorë, në kryeqytetin e Festës së Pavarësisë, në ceremoninë shtetërore për nder të simbolit më përbashkues të shqiptarëve. Përkulem me respekt para veprës së përjetshme të themeluesit të shtetit shqiptar, Ismail Qemali", ka thënë ai.

Kryeministri Edi Rama ka zgjedhur që urimin për shqiptarët ta bëjë në rrjetet sociale, përmes një fotoje me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, mbi flamurin kombëtar të shkrepur pas mbledhjes së përbashkët të dy qeverive në Pejë. Teksa përfaqësuesit më të lartë të shtetit kremtonin në Vlorë festën e pavarësisë, demokratët në Tiranë përkujtuan në të njëjtën ditë 106-vjetorin e pavarësisë dhe 74-vjetorin e çlirimit të vendit.

Nga varrezat e dëshmorëve, lideri i PD-së, Lulzim Basha, ka ftuar shqiptarët të bashkohen në mbrojtje të lirë e demokracisë. "Përkulemi me nderimin më të thellë para simbolit tonë kombëtar, flamurit të Kastriotëve që u ngre për herë të parë në kështjellën e tyre më 28 nëntor 1444. Jam në krah të gjithë qytetarëve që janë ngritur për t'i mbrojtur liritë dhe të drejtat e tyre", ka thënë Basha.



# Dorëheqjet e kryetarëve serbë, demonstrim i shkëputjes së veriut nga administrimi i Kosovës

Analistët politikë Shkëlzen Maliqi dhe Imer Mushkolaj kanë vlerësuar se dorëheqjet e kryetarëve të katër komunave në veri kanë për qëllim demonstrimin e ndarjes së veriut nga administrimi i Republikës së Kosovës. Ata kanë thënë të mërkurën për gazetën "Epoka e re" se këto zhvillime do të mund ta dobësojnë pozicionin e Kosovës në dialogun me Serbinë. Sipas tyre, në veri ka ndodhur një momentum i ri që nuk ka kthim mbrapa. Maliqi dhe Mushkolaj kanë kritikuar drejtuesit e institucioneve shtetërore për mosreagimin e duhur karshi ngjarjeve të fundit në veri të vendit

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 28 nëntor** - Mitrovica Veriore, Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveçani kanë mbetur pa kryetarë legjitimë. Në shenjë revolte ndaj vendosjes së taksës prej 100 përqindësh për produktet serbe, katër kryetarët e këtyre komunave kanë dhënë dorëheqje. Dorëheqja e tyre është komentuar të mërkurën në mënyra të ndryshme nga njohësit e proceseve politike.
Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë për gazetën "Epoka e re" se dorëheqja e kryetarëve të katër komunave në veri të Kosovës është demonstrim i dëshirës së Beogradit dhe të Listës Serbe që veriu të shkëputet nga administrimi i Kosovës. "Ashtu edhe janë deklaruar në protestën e së martës për qëllimin e aksionit të tyre. Është një reagim relativisht i matur për dallim nga reagimet e mëparshme të dhunshme dhe me bllokada të rrugëve dhe të komunikimeve me pjesën tjetër të Kosovës. Aksioni arsyetohet si reagim ndaj taksës prej 100 përqindësh për importin e mallrave nga Serbia në Kosovë, duke e paraqitur këtë si shkelje të të drejtave të serbëve dhe rrezikim të ekzistencës së tyre. Duke qenë se trupat e KFOR-it kanë filluar të martën 'manovrat' disaditëshe në veri, si dhe të drejtën e dakorduar më herët që Policia e Kosovës mund të operojë në veri të Kosovës, Beogradi është kujdesur që të mos provokohen konfliktet me viktima, si dikur kur janë sulmuar pikat kufitare dhe doganat që janë nën kontrollin e administratës tonë", ka deklaruar Maliqi, duke shtuar se zhvillimet në veri lidhen me projektin e shkëputjes së katër komunave në veri në tërësi ose pjesërisht. "Ky projekt së fundi ka dalë si alternativë për arritjen e marrëveshjes finale politike në mes të Kosovës dhe Serbisë, e që kapakun ia ka vënë edhe agjitimi i presidentit Hashim Thaçi, që Lugina e Preshevës, edhe ajo si tërësi ose pjesërisht, t'i bashkohet Kosovës. Deri tash kemi pasur agjitacion, propagandë dhe testim të idesë në qendrat ndërkombëtare, kurse tani, pasi që dialogu mes dy vendeve ka hyrë në fazën finale, po testohet edhe terreni, që të sigurohet statusi i aktit të kryer, në këtë rast demonstrimi se veriun efektivisht e kontrollojnë serbët", është shprehur ai.
Maliqi ka vlerësuar se ky është vetëm një pozicionim dhe jo diçka e realizuar që duhet të zgjidhet në bisedime. "Prej që janë vendosur pikat kufitare në veri dhe Beogradi parimisht është pajtuar me heqjen e strukturave paralele dhe që komunat në veri të lidhen me Prishtinën, pra që rendi dhe siguria atje të kontrollohet nga Policia e Kosovës, që në përbërjen e saj i ka edhe serbët. Veriu është dashur të integrohet plotësisht në administratën e Kosovës, por kjo nuk ka ndodhur, ose ka qenë disi gjysmake, sepse marrëveshja nuk është respektuar, dhe zëvendësimi i strukturave paralele me strukturën administrative dhe politike kosovare është bërë vetëm formalisht, kinse është integruar në sistemin e Kosovës por, objektivisht, përmes Listës Serbe ka mbetur nën kontrollin e plotë të Beogradit, duke vepruar si mjet shantazhues, herë duke marrë pjesë në Qeveri dhe herë në Kuvend, herë duke i bojkotuar institucionet e Kosovës. Tani duan anulimin e krejt procesit, duke u ndarë nga Kosova si dhe ser-



bët në brendi të Kosovës. Por, megjithatë, ky është pozicionim dhe jo diçka e realizuar. Kjo duhet të zgjidhet në tavolinën e bisedimeve", ka theksuar Maliqi. Sipas Maliqit, institucionet e Kosovës sikur janë kapur në befasi dhe po hezitojnë të reagojnë për dorëheqjet e kryetarëve të komunave veriore. "Për shembull, kryeministri Haradinaj të martën nuk ka dashur ta komentojë ngjarjen, mbase për arsye se ka pritur të bëhen analizat. Ai premtoi se do të reagojë të mërkurën. Por, ende nuk e ka marrë mundin të thotë diçka konkretisht, vetëm shfrytëzoi ceremoninë e zëvendësimit të komandantit të NATO-s për të thënë: 'Falë NATO-s Kosova është shtëpi e sigurt'. Mendoj se Qeveria dhe partitë politike tona janë në një situatë të konfuzionit dhe përçarjes. Shumica deklarohen kundër ndarjes së Kosovës dhe këmbimit të territoreve, po nuk i besojnë presidentit Thaçi rreth mundësisë që Lugina e Preshevës të bëhet pjesë e Kosovës. Në esencë, disa po presin sqarimin dhe rreshtimet e Fuqive të Mëdha ose edhe çka do të sjellë Thaçi nga ShBA-ja, ose të shohin se çfarë realisht përmban projekti i këmbimit, a është dëmtues apo i sjell dobi Kosovës", ka deklaruar Maliqi.

### Zhvillimet e fundit në veri dobësojnë pozicionin e Kosovës në dialog

Edhe njohësi tjetër i proceseve politike Imer Mushkolaj ka thënë të mërkurën për gazetën "Epoka e re" se që nga dita e martë kemi një situatë të re në veri të Kosovës për shkak se katër kryetarët e komunave kanë dhënë dorëheqje kinse për arsye të vendosjes së taksës ndaj mallrave të Serbisë. Ai ka thënë se ky është vetëm një arsyetim pas të cilit fshihet destabilizimi i gjendjes në veri në çfarëdo forme. Sipas Mushkolajt, kjo që ka ndodhur në veri e përshpejton procesin e përfundimit të një marrëveshje të pretenduar me Serbinë, por tash në pozicione të reja. "Komunat e veriut e kanë shkëputur lidhjen me Prishtinën dhe tash atje qeverisin strukturat paralele për shkak se secila komunë e ka atë që quhet organ i përkohshëm që është njëfarë lloj institucioni komunal i emëruar nga Qeveria e Serbisë. Tash serbët e kanë forcuar pozicionin duke e krijuar një momentum të ri i cili e dobëson pozicionin e Kosovës në çfarëdo vazhdimi të dialogut me Serbinë. Unë e shoh në aspektin politik këtë që ka ndodhur, edhe pse dikush mund ta arsyetojë si aspekt ekonomik dhe social, por ky është vetëm arsyetim për krijimin e situatës së re", ka deklaruar Mushkolaj, duke shtuar se këto zhvillime flasin për realizimin e një skenari. "Është interesant se pse dhanë dorëheqje kryetarët e komunave të tjera në jug të vendit, por u tërhoqën vetëm këta në veri. Nëse këta paskan pasur probleme për furnizim me bukë, barna e të tjera, pse nuk paskan problem Shtërpca, Graçanica dhe komunat e tjera serbe që nuk janë në veri. Në fakt, po shihet se këtu është një skenar që ka filluar të realizohet, por tash nuk mund të spekuloj se çfarë mund të ndodhë. Kjo qasje e kryetarëve në veri na jep të kuptojmë se bëhet fjalë për një lloj shkëputje së pari të komunikimit, e pastaj përpjekjen për t'u shkëputur edhe në të gjitha format e tjera", ka theksuar ai.

Mushkolaj ka vlerësuar se ajo që ka ndodhur në veri e ka shpërfaqur realitetin e asaj se gjithçka që është thënë deri më tash qoftë nga Prishtina, qoftë nga Brukseli për normalizimin e situatës dhe për funksionimin e institucioneve në veri, paska qenë një maskë. "Për shkak se, siç u pa, vetëm për një moment të caktuar ata njerëz që deri dje janë paguar, kanë marrë privilegje dhe kanë përfaqësuar institucionet sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dinë të tërhiqen dhe t'ia kthejnë shpinën Prishtinës dhe natyrisht të kthehen edhe zyrtarisht kah Beogradi, edhe pse formalisht ata i kanë pasur lidhjet me Beogradin", ka thënë ai, duke mos përjashtuar mundësitë e kthimit të kryetarëve në komuna. "Ata edhe mund të kthehen, por situata e krijuar nuk mund të kthehet mbrapa. Ka ndodhur një momentum në veri që nuk ka kthim mbrapa. Ata formalisht nuk e kanë njoftuar Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, por kjo nuk do të thotë se ata nuk po funksionojnë në veri nën menaxhimin e strukturave paralele dhe kjo është shumë e rrezikshme për shkak se ata nëse nuk e njoftojnë MAPL-në atëherë ministria nuk mund ta njoftojë KQZ-në për shpalljen e zgjedhjeve dhe as nuk mund të merren veprime zyrtare çfarë do të duhej të ndërmerren në një situatë normale. Kjo e bën edhe më të rrezikshme situatën për shkak se atje thjesht mbetet një territor pa qeverisje, respektivisht nën qeverisjen e strukturave paralele", është shprehur Mushkolaj. Ai ka thënë se për zhvillimet në veri nuk ka pasur reagime të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe, sipas tij, kjo është shqetësuese. "Nuk kemi pasur reagime të shpejta të cilat i determinon një situatë e tillë sepse është një situatë e jashtëzakonshme meqë nuk është normale se katër kryetarë të komunave që përbejnë një pjesë të rëndësishme të territorit të japin dorëheqje. Edhe ky mosreagim kam frikë se shkon pikërisht si pjesë e këtij skenari që e përmenda më herët. Ose ndoshta Qeveria e Kosovës ka ndonjë plan tjetër që neve nuk na është prezantuar dhe pret një moment të caktuar që ta prezantojë. Në një situatë të tillë Qeveria dhe institucionet e tjera do të duhej të ishin të gatshme të reagojnë", ka thënë Mushkolaj.

# 28 familjeve u dorëzohen çelësat e 28 shtëpive



Prizren, 28 nëntor (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, së bashku me përfaqësues të organizatës "Jetimët e Ballkanit", të mërkurën, në kuadër të shënimit të 28 Nëntorit, ka marrë pjesë në ndarjen e 28 shtëpive për 28 familje në nevojë në komunën e Prizrenit, të Suharekës dhe të Dragashit. Duke uruar familjet për festën e nëntorit dhe për shtëpitë e tyre të reja, kryeparlamentari Veseli ka thënë se solidariteti është virtyt i përcjell brez pas brezi midis shqiptarëve, i cili duhet rritur dhe kultivuar edhe më tej.

Kryetari i Kuvendit ka thënë se sado të forta qofshin institucionet dhe sado e madhe të jetë përkujdesja e shtetit ndaj qytetarëve, gjithherë do të ketë nevojë për mbështetje dhe solidaritet midis njerëzve. "Ndarja e 28 banesave më 28 nëntor, në këtë festë të madhe kombëtare, mëton ta përçojë mesazhin e afrimit e të bashkimit më të madh të qytetarëve me njëri-tjetrin. E përgëzoj bamirësin Halil Kastrati dhe shoqatën që ai udhëheq për punën e vazhdueshme në ndihmë të qytetarëve në nevojë", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

## Franca përkrah Kosovën në trajtimin e ujërave të zeza dhe reduktimin e ndotjes së ajrit

Prishtinë, 28 nëntor (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka pritur në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, Didier Chabert, me të cilin kanë biseduar për projektet e përbashkët dhe për mundësitë e bashkëpunimit në fushën e mjedisit.
Matoshi ka prezantuar angazhimet e tij për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në vend, duke përfshirë reduktimin e ndotjes së ajrit, trajtimin e ujërave të zeza, fushatën e pastrimit të Kosovës, udhëzimin administrativ për ndëshkime me gjoba mandatore për të gjitha ata që hedhin mbeturina jashtë vendeve të caktuara apo djegin ato etj.
Ministri Matoshi ka folur edhe për projektin e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Prishtinë duke vlerësuar lart bashkëpunimin me qeverinë franceze për realizimin e këtij projekti, me ç'rast ka theksuar se, krahas ndërtimit të impiantit, është shumë e nevojshme të ndërtohen edhe kolektorët në kryeqytet.
Ndërsa ambasadori francez Didier Chabert, pasi ka përgëzuar ministrin për angazhimin e tij në udhëheqje të kësaj ministrie, ka shprehur përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në vendin tonë.
Ambasadori francez u shpreh i kënaqur me angazhimin e palës së Kosovës për realizimin e projektit për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe ofroi gatishmërinë ta përkrahë Ministrinë e Mjedisit edhe në fushën e ajrit, për përafrimin e legjislacionit me BE-në, për ndërtimin e ujëmbledhësve të ri të Kosovës etj.



# Isufaj thotë se ka zhvillime pozitive lidhur me regjistrat e lëndëve nëpër regjione




Prishtinë, 28 nëntor (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka mbajtur takimin e radhës, të cilin e ka udhëhequr kryesuesi i tij, Blerim Isufaj, me ç'rast janë shqyrtuar dhe miratuar një mori pikash. Kryesuesi i KPK-së, Blerim Isufaj, ka njoftuar anëtarët për nënshkrimin e katër akteve të rëndësishme institucionale, të lidhura në emër të Këshillit Prokurorial, siç janë: Marrëveshja e mirëkuptimit me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", e cila ka për qëllim vendosjen e bashkëpunimit në mes të KPK-së dhe Universitetit të Prishtinës për kryerjen e ekspertizave dhe superekspertizave nga ana e ekspertëve të fakulteteve për nevojat e Prokurorit të Shtetit, pastaj marrëveshja me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ndërmarrjen Publike Komunale "Trafiku Urban" në Prishtinë për sigurimin e shërbimit të transportit për të punësuarit në gjykata dhe prokurori në Pallatin e Drejtësisë në Hajvali; Deklarata e përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës për Projektin "Drejtësia 2020", deklaratë kjo që paraqet shprehjen e vullnetit për t'i marrë përsipër përgjegjësitë koordinuese për ta zbatuar agjendën "Drejtësia 2020", duke ushtruar kompetencat e tri institucioneve për ta realizuar përmbylljen e tranzicionit në sistemin e drejtësisë dhe për t'u dhënë fund lëndëve të vjetra, duke vazhduar me marrëveshjen e mirëkuptimit për financimin e projektit "Fuqizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës" nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe Qeveria e Irlandës Veriore, si dhe marrëveshjen e Mirëkuptimit me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë për financimin e zbatimit të Fazës së Konsolidimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve.
Në ndërlidhje me marrëveshjen e fundit, Isufaj ka prezantuar para anëtarëve të KPK-së edhe rrjedhat e vënies në zbatim të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL), me ç'rast ka vlerësuar zhvillimet pozitive lidhur me regjistrat e lëndëve nëpër regjione, raportet e lëndëve të kryera, progresin e kryerjes së tyre dhe zbatimin e planeve të trajnimeve në prokuroritë e vendit. "Sistemi elektronik i SMIL-it është ndër më të avancuarit në rajon dhe më gjerë, i cili llogarit saktë peshën e lëndëve dhe bën shpërndarjen automatike të tyre, duke krijuar mundësi të mëdha të planifikimit dhe parakushte të mëdha për zhvillimin e sistemit prokurorial", ka thënë Blerim Isufaj.
Ndërkohë raportin nëntëmujor të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për harmonizimin e statistikave për veprat penale karakteristike e ka prezantuar drejtori i sekretariatit të KPK-së, Lavdim Krasniqi, me ç'rast ka theksuar se gjatë parashtrimit të kallëzimeve penale, 82.64 për qind kanë rezultuar me aktvendime fajësuese të nxjerra nga ana e gjykatave të vendit, e dhënë kjo të cilën anëtarët e Këshillit Prokurorial e vlerësuan lart, ngaqë tregon performancë të mirë të prokurorëve dhe nxjerrë suksesin e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

## Veseli bën nderime te varri i Adem Demaçit për 28 nëntor

Prishtinë, 28 nëntor (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, me rastin e Festës së 28 Nëntorit, ka bërë të mërkurën homazhe te varri i veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Adem Demaçi. Në shenjë kujtimi dhe nderimi për jetën dhe veprën e Demaçit, në shërbim të kombit dhe atdheut, Veseli vendosi lule pranë varrit të tij. "Sot është një ditë e madhe për kombin tonë. Në këtë ditë kemi për obligim të jemi pranë kujtimit të atyre që me jetën e tyre e nderuan kombin. I tillë ishte Adem Demaçi, simboli më unik i gjithë lëvizjes sonë kombëtare për lirinë e Kosovës. Gjithë jeta e Adem Demaçit ishte në shërbim të frymës së 28 nëntorit, prandaj sot jemi këtu për të nderuar dhe për t'u përkulur para këtij burri të madh të kombit", ka thënë Veseli. Po ashtu, kreu i Kuvendit ka bërë homazhe edhe te varret e gjeneralmajor Ilir Konushevcit, hero i kombit dhe dr. Hazir Malaj, dëshmor i kombit.



Ndërrohet komanda e KFOR-it në Kosovë

# Shkon Salvatore Cuoci, vjen Lorenzo D'Addario

Të mërkurën është mbajtur ceremonia e ndërrimit të komandës së KFOR-it nga komandanti i deritanishëm, gjeneralmajor Salvatore Cuoci, te gjeneralmajor Lorenzo D'Addario. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm ushtarë të KFOR-it, oficerë, përfaqësues institucionalë, përfaqësues të korit diplomatik dhe personalitete të tjera. Në këtë ceremoni mbajti fjalë rasti edhe admirali James Foggo, komandant i Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli, i cili vlerësoi rolin e madh të forcave të KFOR-it dhe bashkëpunimin me institucionet e Kosovës



EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Në një ceremoni solemne të mërkurën është bërë ndërrimi i komandës së KFOR-it nga komandanti i deritanishëm, Salvatore Cuoci, te Lorenzo D'Addario. Komandanti i deritanishëm, gjeneralmajor Salvatore Cuoci, ka falënderuar të gjithë ushtarët dhe komandantët që kanë shërbyer bashkë me të, për ta bërë Kosovën vend më të mirë. Po ashtu, Cuoci ka falënderuar edhe lidershipin e vendit që kanë luajtur rol të veçantë duke e përforcuar partneritetin e tyre. "KFOR-i është një storie e suksesit", ka thënë komandanti Cuoci.

Në këtë ceremoni mbajti fjalë rasti edhe admirali James Foggo, komandant i Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli, i cili vlerësoi rolin e madh të forcave të KFOR-it dhe bashkëpunimin me institucionet e Kosovës. Ky është kalimi i komandës së 22-të, në atë të 23-të, që nga viti 1999 kur KFOR-i operon në Kosovë. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm ushtarë të KFOR-it, oficerë, përfaqësues institucionalë, përfaqësues të korit diplomatik dhe personalitete të tjera.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka falënderuar admiralin James Foggo, komandant i Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli dhe të gjithë liderët e tjerë ushtarakë për mbështetjen e vazhdueshme dhe për rolin e tyre në sigurimin dhe mirëmbajtjen e paqes në Kosovë. Haradinaj me këtë rast ka vlerësuar lart punën e ushtarëve të KFOR-it, duke thënë se në Kosovë është krijuar një klimë e qetë dhe e sigurt për të gjithë qytetarët. Ai ka thënë se Qeveria dhe qytetarët e Kosovës janë mirënjohës për të gjithë burrat dhe gratë që shërbyen dhe vazhdojnë të shërbejnë në vendin tonë, duke mbështetur paqen, sigurinë dhe stabilitetin. "Falë NATO-s sot Kosova është shtëpi e të gjithëve pa dallim etnie, feje apo ndonjë grupi tjetër. Ne tregojmë respektin më të thellë dhe kujtojmë të gjithë ushtarët që humbën jetën gjatë shërbimit në Kosovë. Liria jonë është një vlerë e përbashkët, një vlerë e Kosovës dhe aleatëve", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke vlerësuar punën e madhe që ka bërë gjenerali Couci si komandant i KFOR-it në shumë fusha.

Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka thënë se të gjitha institucionet e sigurisë të Kosovës, si Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, AKI-ja, Doganat, mekanizmat e kontrollit kufitar dhe të gjitha institucionet e tjera të sigurisë dhe emergjencat, kanë qenë dhe do të jenë partnere të besueshme të KFOR-it. "Kosova do ta respektojë përgjithmonë praninë e KFOR-it dhe NATO-s. Ne synojmë ta forcojmë partneritetin", është shprehur Haradinaj.

Haradinaj duke uruar komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralin Lorenzo D'Addario, e ka siguruar atë se do ta ketë gjithë angazhimin e Qeverisë së Kosovës për të punuar së bashku, duke e bërë Kosovën dhe rajonin një mjedis të qetë dhe të sigurt. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka uruar komandantin e ri të KFOR-it në Kosovë, Lorenzo D'addario, ndërkaq ka falënderuar gjeneralin Cuoci për kontributin e tij në krye të forcave të NATO-s në vendin tonë. "Uroj komandantin e ri të KFOR-it në Kosovë, Lorenzo D'addario, që sot pranoi detyrën nga paraardhësi i tij, gjeneral Salvatore Cuoci, të cilin e falënderoj për bashkëpunimin dhe punën gjatë shërbimit në vendin tonë. Kosova është vend i sigurt dhe faktor paqeje e stabiliteti në rajon. Sikurse deri më tani, KFOR-i do ta ketë bashkëpunimin e plotë të institucioneve të Kosovës, në funksion të përmbushjes së detyrave dhe misionit të tij, në shërbim të gjithë qytetarëve pa dallim", ka theksuar kryeparlementari Veseli.

## Foggo: Pakënaqësitë për taksën të zgjidhen përmes dialogut

Pas ceremonisë së ndërrimit të komandës së KFOR-it nga Salvatore Couci te Lorenzo D'addario, admirali amerikan James Foggo, komandant i Komandës së Forcave të Bashkuara Aleate në Napoli, ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka folur edhe për taksën 100 për qind që Kosova ka vendosur për produktet e Serbisë dhe të Bosnjës. Ai thënë se e kupton frustrimin e qytetarëve serbë në veri të Kosovës, të cilët po protestojnë kundër vendosjes së tarifës 100 për qind që ua ka vënë Qeveria e Kosovës prodhimeve të Serbisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës. "Unë sigurisht se e kuptoj frustrimin e njerëzve, të gjithë njerëzve që preken nga rritja e tarifave. Po ashtu, e di se ka pasur disa protesta dhe në demokraci, në një shtet demokratik. Këtu po flasim për dy demokraci, po flasim për Kosovën dhe Serbinë. Unë gjithmonë kam mbajtur qëndrimin se qytetarët që kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për të votuar, kanë zë. Prandaj, ata edhe mund të protestojnë", ka thënë Foggo. Megjithatë, ai ka theksuar nevojën që protestat të jenë paqësore, duke bërë thirrje që këto pakënaqësi duhet të zgjidhen përmes dialogut. "Nëse ka protesta, unë gjithmonë kam inkurajuar, në fakt, kam kërkuar që ato të jenë paqësore. Prandaj, nuk është e nevojshme të thërrasim asnjë forcë policore, atë të EULEX-it ose KFOR-it. Unë parapëlqej që të zhvillohet një dialog, në mënyrë paqësore. Prandaj, keni të drejtë vote, prandaj keni të zgjedhur të popullit dhe ato tensione, ato frustrime, duhen adresuar te të zgjedhurit, nëse është e nevojshme, në të dyja anët e kufirit", ka deklaruar Foggo.





Flet për "Epokën e re", Fehmi Mehmeti

# Duhet të ketë rënie të normave të interesit në institucionet mikrofinanciare



Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare gjatë këtij viti ka shënuar rritje në të gjithë indikatorët e tij. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se te ky sektor normat e interesit vazhdojnë të mbesin të larta, duke bërë thirrje që ato të kenë rënie. Duke folur rreth mundësisë së krijimit të bankës së diasporës, Mehmeti ka thënë se BQK-ja mirëpritur një iniciativë të tillë. Ai ka bërë me dije se janë në proces të ndryshimit të dy ligjeve esenciale të sektorit financiar: Ligjit për banka dhe ndryshimit të Ligjit të autopërgjegjësisë. "Këto dy ligje do t'u japin dimension të ri zhvillimeve në sektorin bankar, por edhe në sektorin e sigurimeve", ka thënë Mehmeti

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 NËNTOR - **"Epoka e re":** *Z. Mehmeti, si është momentalisht gjendja e sektorit financiar? Çfarë shume të depozitave kemi në raport me kreditë?*

**Mehmeti:** Sektori financiar është duke pasur rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm në asete dhe në tregusit e tjerë financiarë. Sektori bankar, si sektori më i madh në kuadër të sistemit financiar, vazhdon të performojë mirë në kredi dhe në depozita. Deri në muajin shtator të këtij viti vlera e përgjithshme e depozitave në sektorin bankar të vendit ka arritur në 3.2 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 5.4 përqindësh. Kjo rritje e qëndrueshme e depozitave ka mundësuar zgjerimin e vazhdueshëm të kredive, të cilat në shtator 2018 arritën vlerën prej 2.7 miliardë eurosh e cila paraqet rritje vjetore prej 11.4 përqindësh. Gjithashtu, sektori i sigurimeve ka filluar konsolidimin e tij, vlera e primeve të shkruara bruto në shtator 2018 ishte 69 milionë euro, duke shënuar rritje vjetor prej 4.8 përqindësh. Vlera e dëmeve të paguara bruto në shtator 2018 është 31.5 milionë euro, me një rritje vjetore prej 8.2 përqindësh. Edhe treguesit e sektorit mikrofinanciar kanë shënuar rritje, ku vlera e aseteve të këtij sektori në shtator të këtij viti është 236.2 milionë, me një rritje prej 28.6 përqindësh, ndërsa kreditë shënuan vlerën prej 173.7 milionë eurosh, apo rritje vjetore prej 28.6 përqindësh.

"Epoka e re": Është paralajmëruar rëni e normave të interesit në vitin 2019.

Mehmeti: Sikurse thashë edhe më parë, sistemi financiar në Kosovë, në veçanti sektori bankar gëzon besim të lartë të publikut, që është shprehur në rritje të qëndrueshme dhe të shëndetshme që nga fillimi i funksionimit të tij. Sa iu përket normave të interesit, ka zhvillime shumë pozitive që janë reflektuar me uljen e dukshme të normave të interesit. Bazuar në të dhënat e muajit gusht 2018, norma efektive e interesit ishte 6.34 për qind, që përfshin bizneset dhe ekonomitë familjare, përderisa norma e interesit vetëm për biznese është nën 5.82 për qind. Në raste të caktuara për kreditë hipotekare norma e interesit sillet nga 4 për qind deri në 5 për qind. Marrë parasysh trendin e vazhdueshëm të uljes së normave të interesit si dhe konkurrencën gjithnjë në rritje të sektorit bankar, vlerësojmë se bankat do të vazhdojnë të reflektojnë në uljen e mëtutjeshme të normave të interesit edhe pse, siç është cekur tani, normat ekzistuese janë përgjithësisht të njëjta me ato të vendeve të tjera.

**"Epoka e re":** *Për çfarë përqindje bëhet fjalë?*

**Mehmeti:** BQK-ja në vazhdimësi angazhohet për krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e aktivitetit bankar, me konkurrencë të drejtë, gjithmonë duke zbatuar praktikat më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian. Në të njëjtën kohë, rritja ekonomike, ndryshimet legjislative në kohën e fundit, që ndërlidhen me lehtësimin e ekzekutimit të kolateralit dhe zbatimit të kontratave, edukimit të vazhdueshëm financiar, si të individëve, po ashtu edhe të bizneseve në Kosovë, edhe cilësia e mirë e portofolit kreditor në sektorin bankar, mund të ndikojnë në rënie të mëtejme të normave të interesit.

**"Epoka e re":** *Sa iu përket institucioneve mikrofinanciare dhe normave të larta të kamatave që aplikojnë, deri ku ka shkuar çështja legjislative e tyre?*

**Mehmeti:** Sa i përket sektorit të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, edhe ky sektor gjatë këtij viti ka shënuar rritje në të gjithë indikatorët e tij. Gjithsej asetet e këtij sektori në muajin shtator 2018 ishin në shumë prej 236.2 milionë eurosh, me një rritje vjetore prej 28.6 përqindësh. Gjithashtu, vlera e kredive të këtij sektori prej 173.7 milionë eurosh ka shënuar rritje vjetore prej 28.6 përqindësh. Kjo nënkupton që ky sektor po luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Megjithatë, te ky sektor normat e interesit vazhdojnë të mbesin të larta, për të cilat vlerësojmë se duhet të ketë rënie. Sa i përket çështjes legjislative, Ligji është në procedurë të aprovimit nga ana e organeve kompetente. Ne si BQK kemi qenë të angazhuar për të dhënë dhe vazhdojmë të japim kontribut dhe ekspertizë që ky ligj të jetë në harmoni me direktivat evropiane me qëllim të rregullimit sa më të mirë të këtyre institucioneve.

**"Epoka e re":** *Zëvendëspresidenti i Bankës Qendrore Evropiane (BQE), Luis De Guindos, ka paralajmëruar menaxhuesit e aktiveve jobankare se do të përballen me mbikëqyrje më të ashpër. A pritet që BQK-ja të jetë më e ashpër për institucione mikrofinanciare dhe jobankare?*

**Mehmeti:** Në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të arritjes së objektivave të parapara me ligj dhe me qëllim të sigurimit të stabilitetit financiar në vend, BQK-ja kryen aktivitetin e vet mbikëqyrës ndaj të gjitha institucioneve financiare që kryejnë aktivitet financiar në Kosovë. Për këtë qëllim, BQK-ja në vazhdimësi kryen edhe ekzaminime të rregullta kundrejt institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, me qëllim të vlerësimit të menaxhimit të rrezikut, pajtueshmërisë me legjislacionin e BQK-së dhe politikat e brendshme të tyre, qeverisjes koorporative dhe fusha të tjera të parapara me planin vjetor të ekzaminimeve të BQK-së. BQK-ja do të vazhdojë ta kryejë mbikëqyrjen e këtij sektori edhe në të ardhmen me qëllim të realizimit të funksioneve të saj mbikëqyrëse dhe rregullative.

**"Epoka e re":** *Është përmendur edhe mundësia e krijimit të Bankës së Diasporës, çfarë infrastrukture ligjore nevojitet për këtë dhe a është bërë ndonjë hap në këtë drejtim?*

**Mehmeti:** Duke pasur parasysh rëndësinë e diasporës, vlerësoj se ka hapësirë për një partneritet edhe më të madh



ekonomik ndërmjet Kosovës dhe diasporës, duke rritur kontaktet ndërmjet institucioneve dhe afaristëve vendorë me afaristët nga diaspora, për t'i pasqyruar më për së afërmi mundësitë që i ofron ekonomia e Kosovës. BQK-ja mirëpret investimet e mundshme nga diaspora në sistemin tonë financiar dhe, përbrenda fushëveprimtarisë së saj, është e gatshme të mbështesë, me të gjitha kapacitetet e saj, çdo iniciativë për të investuar në Kosovë. Për këtë qëllim ne kemi mirëpritur një iniciativë të tillë, jemi takuar me iniciatorët dhe i kemi informuar lidhur me kërkesat ligjore të BQK-së për licencimin e një banke.

**"Epoka e re":** *Çfarë risish të tjera pritet të kemi në vitin 2019 sa i përket sektorit financiar?*
**Mehmeti:** Në fakt, në sektorin financiar vazhdimisht kemi synuar të kemi zhvillime pozitive. Në këtë drejtim, gjatë vitit të ardhshëm pritet ta avancojmë rregullativen si dhe të bëjmë diagnoza më rigoroze në kontekst të funksionimit të sistemit financiar në vend, pse jo edhe diagnoza më rigoroze në funksionimin e BQK-së. Në këtë drejtim, do të jemi në hap me rregullativen ndërkombëtare, po ashtu do të jemi proaktiv në shumë fusha. Aktualisht jemi në proces të ndryshimit të dy ligjeve esenciale të sektorit financiar, si Ligji për banka, që do të procedohet si ligj i ri si dhe plotësim/ndryshimi i Ligjit të autopërgjegjësisë. Këto dy ligje do t'i japin dimension të ri zhvillimeve në sektorin bankar, edhe sektorit të sigurimeve. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i rregulloreve do të aprovohen dhe do të sjellin avancim për industrinë financiare, përfshirë këtu edhe rregullativen për "recovery and resolution".

# Bankat në Kosovë të rrezikuara nga grupet e armatosura kriminale

**Prishtinë, 28 nëntor (ER)** - "Gjatë vitit 2018 sektori bankar në Kosovë është ballafaquar me një numër të paprecedent të rasteve të sulmeve fizike ku shumica prej tyre ishin grabitje të kryera nga grupe të rrezikshme kriminale të armatosura me armë të gjata", kështu është thënë në reagimin e Shoqatës së Bankave të Kosovës pas grabitjes së fundit që ndodhi këto ditë në bankën "TEB" në Prishtinë.

Derisa dëmet materiale ishin të larta, Shoqata e Bankave të Kosovës shpreh shqetësimin më të madh për sigurinë e klientëve dhe stafit të bankave. "Sektori bankar punëson rreth 3 500 punëtorë dhe shërben mijëra klientë për çdo ditë duke ofruar kështu shërbime financiare shumë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës, prandaj për bankat është prioritet që klientët e tyre të ndihen rehat dhe të sigurt për marrjen e shërbimeve në banka si dhe që punonjësit e bankave ta kryejnë punën e tyre në një mjedis të sigurt", është thënë në këtë reagim.

Sipas Shoqatës së Bankave të Kosovës, në disa prej këtyre sulmeve punonjësit e bankave janë lënduar dhe është dashur të pranojnë trajtim mjekësor pasi që këto grupe mafioze janë zakonisht shumë të rrezikshme dhe të dhunshme në sulmet e tyre. "Për më shumë, këto grabitje i fuqizojnë këta kriminelë që ta përdorin paranë e vjedhur për të blerë në mënyrë të jashtëligjshme armë, drogë dhe të kryejnë shumë krime të tjera brenda Kosovës dhe në rajon, duke rezultuar në gupe të organizuara kriminale gjithnjë e më të fuqishme, që paraqet kërcënim për sigurinë e vendit. Bazuar në statistikat e ofruara nga Policia e Kosovës, bizneset e tjera në Kosovë janë duke u ballafaquar me sulme në baza të rregullta dhe u nënshtrohen rreziqeve dhe kërcënimeve të tilla", është thënë në reagimin e kësaj shoqate.




Shoqata e Bankave të Kosovës u ka bërë thirrje institucioneve të sigurisë në Kosovë të ndërmarrin masa urgjente dhe të fuqishme kundër këtyre grupeve kriminale për t'i shpartalluar ato dhe për të siguruar mjedis të sigurt për bizneset e Kosovës, duke u dhënë vëmendje të veçantë institucioneve financiare.

# I jepet lamtumira e fundit veprimtarit Rrahman Dërmaku



KAMENICË, 28 NËNTOR (ER) - Të mërkurën i është dhënë lamtumira e fundit veprimtarit të çështjes kombëtare të vitit '81, Rrahman Dërmakut nga Shipashnica e Kamenicës. I ndjeri ishte ndër mërgimtarët e parë që u rreshtua në radhët e lëvizjes kombëtare në mërgim në krye me Kadri Zekën dhe Jusuf Gërvallën.
Për shkak të aktiviteteve të tij, ai u ndoq nga pushteti i atëhershëm dhe u arrestua dhe u dënua me dy vjet burgim, duke qëndruar i fortë përballë presioneve.
Edhe pas burgut, i ndjeri nuk pushoi asnjëherë së punuari për çështjen kombëtare.
Dërmaku ndërroi jetë të martën në moshën 70-vjeçare pas një sëmundje të rëndë e cila e mori shumë shpejt. Telegram ngushëllimi familjes Dërmaku me rastin e humbjes së të ndjerit Rrahmn Dërmaku i kanë dërguar bashkëveprimtarët e tij nga Zvicra.



# Aktakuzë kundër katër personave për falsifikim të dokumenteve për rastin e veteranëve

MITROVICË, 28 NËNTOR - Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega Skenderaj, kundër të pandehurve M. I., F. H., H. F. dhe B. H. për veprën penale "Mashtrim", nga neni 335, paragrafi 2, si dhe "Falsifikimi i dokumenteve", nga neni 398, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).
Prokuroria ka njoftuar se të pandehurit në fillim të vitit 2018, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, kanë paraqitur fakte të rreme duke lëshuar certifikata dhe vërtetime të veteranëve të luftës. Po ashtu, të dyshuarit e lartcekur kanë përpiluar dokumentacionin - certifikata dhe vërtetime të veteranëve në emër të këtyre personave me qëllim të shfrytëzimit të këtyre dokumenteve si origjinale.
Me këto veprime, të pandehurit kanë kryer veprat penale "Mashtrim", nga neni 335, paragrafi 2, si dhe "Falsifikimi i dokumenteve", nga neni 398, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).
Të njëjtit me këto veprime kanë dëmtuar rreth 60 persona, me ç'rast për një veprim të tillë kundërligjshëm kanë përfituar deri në 2 500 euro.
Prokurori i Shtetit i ka propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shpallë fajtorë për veprat e kryera penale dhe t'i dënojë sipas ligjit.



# Vihet gurthemeli për ndërtimin e objektit të ri të shkollës 'Heronjtë e Kosovës'

RAHOVEC, 28 NËNTOR (ER) - Është vënë gurthemeli për ndërtimin e objektit të ri të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Heronjtë e Kosovës" për fshatrat Hoçë e Vogël dhe Brestoc të Komunës së Rahovecit. Në ceremoninë e vënies së guthemelit i pranishëm ishte kryetari i komunës, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë, nxënës, mësimdhënës dhe qytetarë të fshatrave Hoçë e Madhe dhe Brestoc. "Sot e vumë gurthemelin e objektit të ri të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Heronjtë e Kosovës' për fshatrat Hoçë e Vogël dhe Brestoc. Do ta vazhdojmë ndërtimin e shkollave dhe përmirësimin e kushteve në mësim, përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, sepse arsimi është baza e zhvillimit të shoqërisë dhe prioritet imi", ka thënë Latifi.

# Komuna e Malishevës shpërndanë 80 makina shpërndarëse të plehut

MALISHEVË, 28 NËNTOR (ER) - Në kuadër të projekteve për subvencionimin e bujqve lokal, Komuna e Malishevës ka shpërndarë 80 makina shpërndarëse të plehut për 80 bujq të kësaj komune. Me këtë rast, nënkryetari i Malishevës, Hajdin Berisha, ka thënë se bujqësia është prioritet i qeverisjes komunale. "Bujqësia është prioritet yni si qeverisje komunale dhe jemi duke bërë më të mirën e mundshme që t'i përkrahim bujqit dhe fermerët tanë me subvencione të ndryshme. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, sot po e realizojmë edhe subvencion e gjashtë me radhë për këtë vit në sektorin e bujqësisë", ka thënë Berisha.
Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Murat Hoxha, ka bërë me dije se ky projekt i subvencionimit për 80 makina shpërndarëse të plehut ka kushtuar rreth 14 mijë euro dhe është mundësuar nga buxheti i Komunës së Malishevës.



# Serbisë s'duhet t'i jepet asgjë!



Nga Shemsi SYLA

Rreth 13 500 njerëz humbën jetën në luftën e fundit në Kosovë. Sipas të dhënave zyrtare, në Kosovë ka mbi 130 mijë shtëpi të rrënuara, mbi 12 mijë civilë të vrarë dhe të masakruar, mbi 20 mijë femra të dhunuara. Kësaj shifre duhet shtuar edhe të zhdukurit, madje edhe të dëbuarit nga trevat e tyre; mbi 800 mijë veta të moshave dhe gjinive të ndryshme. Mbi 22 miliardë euro llogariten dëmet e luftës që Serbia ka shkaktuar në Kosovë para dhe gjatë luftës së fundit (1990-1999).
Në vitin 1878 Serbia bëri dëbimin masiv të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit dhe rajoni i Toplicës, përmes dhunës dhe terrorit të organizuar shtetëror, ushtroi gjenocid dhe spastrim etnik mbi 700 vendbanime dhe mbi 300 000 shqiptarë, të cilët asokohe jetonin në trojet e veta etnike, apo në një hapësirë sa territori aktual i Kosovës.
Në vitin 1912 dhe 1913 serbët kanë vrarë 120 000 shqiptarë - burra, gra, djem, pleq, plaka dhe fëmijë. Qindra fshatra janë goditur me armatime të rënda, artileri dhe topa. Një numër i madh i fshatrave në Kosovë, por edhe në Maqedoni, janë djegur. Të paktën 50 000 shqiptarë, për ta shpëtuar jetën nga masakrat e forcave ushtarake serbe, u detyruan t'i braktisin trojet e veta, të bëhen refugjatë dhe të ikin për në Turqi dhe Shqipëri.
Për jetësimin e filozofisë pansllaviste, gjatë këtyre periudhave, nga Kongresi i Berlinit e këndej, shteti serb ka hartuar rreth 25 elaborate për shfarosjen, asimilimin dhe dëbimin e shqiptarëve. Kjo është shkurtimisht një përmbledhje e gjenocidit dhe dhunës serbe ndaj shqiptarëve dhe ky është çmimi që kanë paguar shqiptarët për ta ruajtur qenien kombëtare dhe për ta fituar lirinë.
Pas gjithë kësaj dhune, sot ka zëra nga qendrat e vendosjes globale që po sugjerojnë se për ta njohur Serbia pavarësinë, Kosova duhet t'i japë edhe diçka Serbisë. Pra, nuk qenka i mjaftueshëm gjenocidi dhe dhuna sistematike e Serbisë për gati dy shekuj me radhë, por po u dashka që Kosova, në këtë rast, të japë edhe diçka; ose territor ose autonomi politike për serbët e Kosovës.
Edhe procesi i bisedimeve të Vjenës pat filluar me këso këshillash të ngjashme; për ta fituar Kosova pavarësinë, duhet të krijojë komuna të reja me shumicë serbe në emër të decentralizimit të pushtetit. Kishat dhe manastiret mesjetare në Kosovë, morën emër të përveçëm duke u shndërruar në kisha e manastire serbe e jo ortodokse, siç edhe janë në fakt. Pos kësaj, këto kisha e manastire, bashkë me gërmadhat e kishave të rrënuara ndër shekuj, një pjesë e tyre kisha katolike, u sllavizuan dhe u përcaktuan si zona me status të veçantë - mbrojtës.
Kurse pakicat, sidomos ato serbe, në komunat e reja që do të krijoheshin, do të kenë kompetenca shtesë në raport me komunat tjera me popullsi shqiptare; gjuha serbe do të njihet si gjuhë e dytë zyrtare në Kosovë dhe pakicat do të kenë 20 vende të garantuara të deputetëve në Kuvendin e Kosovës, 10 vende pakicat tjera dhe 10 vende pakica serbe. Ky ishte kompromisi që sipas negociatorëve në Vjenë, duhet të bënte Kosova në raport me Serbinë, për të mundësuar shpalljen e pavarësisë.
Kur udhëheqësit ndërkombëtarë të këtyre bisedimeve u bindën se pavarësisht këtyre kompromiseve, prapë se prapë Serbia nuk do ta njohë pavarësinë dhe formimin e shtetit të Kosovës, Kombet e Bashkuara e autorizuan ish-kryeministrin finlandez Marti Ahtisari që të hartojë një plan apo pako me propozime konkrete për statusin e ardhshëm të Kosovës. Kështu, Pakoja e Ahtisarit u bë edhe baza mbi të cilën u shpall pavarësia e Kosovës, u hartua kushtetuta dhe ligjet e detyrueshme që parashihte kjo pako.
Kur u shpall pavarësia e Kosovës ishin diku 14 ligje të Pakos së Ahtisarit që duhej të votoheshin në Kuvendin e Kosovës, në paketë. Për këtë qëllim, u formua edhe një komision me përfaqësues të të gjitha partive parlamentare që do të diskutonin për secilin ligj veç e veç që parashihte kjo pako. Ka pasur raste kur përfaqësuesit shqiptarë në këtë komision, me argumente bindëse kanë bërë ndryshime dhe amandamentime të neneve, sidomos në Projektligjet e Trashëgimisë Kulturore dhe zonave të veçanta, por në Kuvend kanë intervenuar ambasadat e shteteve perëndimore duke urdhëruar se këtyre ligjeve nuk guxon t'u ndryshohet as edhe një pikë apo presje dhe janë votuar ashtu siç kishin ardhur te ky komision i veçantë.
Pra, u respektuan procedurat, por jo përmbajtja e këtyre projektligjeve.
Argument i faktorit ndërkombëtar për sjelljen në mënyrë të tillë, duke diktuar substancën e këtyre ligjeve ka qenë: "Këto qëndrime e ndryshime në këto ligje, është dashur t'i shfaqni dhe t'i argumentoni gjatë procesit të bisedimeve në Vjenë, e jo tani".
Ky është një argument i fortë që duhet pasur parasysh edhe tash kur po thuhet se me Serbinë ka ardhur koha për të bërë një marrëveshje përfundimtare që do të jetë ligjërisht e obligueshme për të dy palët.
Kosovës i duhet një marrëveshje me Serbinë që siguron marrëdhënie të qëndrueshme të fqinjësisë së mirë, me respektim të të drejtave të serbëve në Kosovë dhe shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Njohja e Kosovës nga Serbia duke shkëmbyer tokë për paqe, nuk siguron as njohje as paqe të qëndrueshme ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve.
Prandaj, është e domosdoshme një platformë që garanton konsensus dhe mundëson formimin e një komisioni ku duhet të përfshihen ekspertët më të mirë që kemi, për të mbrojtur edhe para faktorit ndërkombëtar të drejtën e shtetit që kemi shpallur në vitin 2008 e që ka marrë edhe legjitimitetin juridik nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.
Të drejtën juridike ndërkombëtare e kemi fituar, tani duhet ta fitojmë edhe betejën e imponuar politike në raport me Serbinë, duke nxjerrë mësime nga procesi i bisedimeve të Vjenës dhe duke mos lejuar të hartohen projekte të paanalizuara e të pastudiuara mirë, sepse, ndërkombëtarët do të na përsërisin faksin se "këto qëndrime është dashur t'i mbani gjatë procesit të bisedimeve me Serbinë, e jo tani".

# Të gjithë mbrojnë krimin e organizuar, si 'UNMIV-i' '(i Veriut)' dhe BE-ja?!



Nga Jakup KRASNIQI

Nuk ka asnjë dyshim, në komunat veriore me shumicë serbe, nga fillimi e deri më sot ka sunduar krimi i organizuar serb, në krye të të cilit kanë qenë dhe ishin të gjithë presidentët e Serbisë, përfshirë edhe këtë të fundit.
Se kriminelët serbë nuk duhet të jenë të qetë, kjo është edhe e kuptueshme, e kuptueshme është edhe kur këtyre u del në mbrojtje Vuçiqi dhe i gjithë aparati i tij kriminel, madje disi e kuptova edhe "shefin" e "UNMIV-it" (e quajta UNMIV, se është vetëm për veriun), që bashkëqeverisi me kriminelët e asaj pjese prej që është instaluar në veri (në vitin 2008), por më vjen keq pse zyrtarë të BE-së (zëdhënësja), por edhe të tjerë, vrapojnë të vihen në mbrojtje të strukturave kriminale serbe në atë pjesë të Kosovës.
Pa dyshim, pa faj nuk janë as të gjitha qeveritë e pas luftës, e sidomos qeveritë e pavarësisë të cilat as edhe një herë problemin e veriut nuk e shtruan si duhet në asnjë nivel politik, përkundrazi, nga viti 2012/13 e këndej në institucionet e Kosovës kanë sjellë struktura që i përgjigjën Beogradit e jo Kosovës e as interesave të qytetarëve serbë të cilët Serbia i konsideron "mish për top". Kulmi i krejt kësaj është arritur këtë vit në Kosovë, kur temë qendrore në çdo segment të shoqërisë sonë është bërë tema serbe për ndarjen e Kosovës.
Zhvillimet e këtyre dite, sidomos taksa 100 për qind për mallrat serbe, ishte vetëm një shkas, shkaqet e vërteta të këtyre veprimeve të serbëve të veriut duhen kërkuar te politika serbe e pastaj edhe te bisedimet politike të Brukselit që prodhuan "Listën serbe" e cila i përgjigjet vetëm Beogradit. Te situata e sotme do të na sillte çdo përpjekje e Kosovës për ta vendosur atje sundimin e rendit e të ligjit, siç ishte taksa dhe arrestimi i vrasëseve të Oliver Ivanoviqit.
Të gjithë mbështetësit e ndarjes së Kosovës duhet ta dinë se pas një veprimi të tillë, të ndarjes së Kosovës, duhet të pushojnë të gjitha pengesat që çojnë në drejtim të bashkimit të Kosovës e të trojeve të tjera shqiptare me Shqipërinë! Mbase kjo është mënyra e vetme për të garantuar paqen dhe sigurinë në Ballkan!
Padrejtësia që iu bë shqiptarëve para 105 vjetëve në Konferencën e Fuqive të Mëdha në Londër duke i bërë copë-copë tokat shqiptare, ka krijuar disbalancë dhe pasiguri në Ballkan, pasojat e të cilit vendim të padrejtë po i bartim edhe sot.



Kompania e Sigurimeve - Insurance Company
KOSOVA eRE


ORIGINAL RECIPE
BIRRA
PEJA
PILSNER
BIRRA PEJA
1971
BIRRA
PEJA

## Mbretëria e Bashkuar do të jetë më e varfër pas Brexit-it



LONDËR, 28 NËNTOR - Mbretëria e Bashkuar do të jetë më e varfër ekonomikisht pas daljes nga Bashkimi Evropian, apo Brexit-it, tha Thesari britanik.
Sipas shifrave të tij, ekonomia britanike mund të dobësohet për 3.9% pas 15 vjetësh. Kjo, nëse Britania del nga BE-ja në bazë të planit aktual të kryeministres britanike, Theresa May. Nëse nuk ka marrëveshje për Brexit, ekonomia mund të dobësohet për 9.3 për qind, paralajmëroi Thesari.
Britania duhet të dalë nga Bashkimi Evropian deri më 29 mars të vitit të ardhshëm.
Britanikët e kanë marrë vendimin për Brexit në një referendum në vitin 2016.
Me planin e kryeministres May, Britania do të mund të negociojë marrëveshje tregtare gjatë periudhës së transicionit, pas 29 marsit, porse nuk do të jetë në gjendje t'i zbatojë ato derisa të përfundojë periudha e transicionit prej 21 muajsh.
Parlamenti britanik do të votojë për planin e kryeministres May më 11 dhjetor.

# Trumpi mund të anulojë takimin me Putinin për shkak të Ukrainës

Presidenti Trump tha se pret raportin nga ekipi i tij i sigurisë kombëtare në lidhje me incidentin, përpara se të vendosë për takimin me Putinin, i cili është pritur të adresojë një sërë çështjesh, nga kontrolli i armëve deri te konfliktet në Siri dhe Ukrainë



UASHINGTON, 28 NËNTOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se po shqyrton anulimin e takimit të tij të planifikuar me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, në samitin G-20, grupit të vendeve më të industrializuara, për shkak të arrestimit të dhjetëra marinarëve ukrainas nga Rusia.
Ai i bëri këto komente në një intervistë për gazetën "Washington Post", derisa presidenti i Ukrainës, Petro Poroshenko, paralajmëroi për kërcënimin e "luftës në shkallë të plotë" me Rusinë.
Udhëheqësit evropianë po ashtu thanë se po shqyrtojnë një rreth të ri sanksionesh kundër Rusisë, për shkak të aneksimit të tri anijeve të Ukrainës dhe ekuipazhit të tyre pas një konfrontimi në det, në brigjet e Krimesë, më 25 nëntor.
Trumpi tha se pret "raportin e plotë" nga ekipi i tij i sigurisë kombëtare në lidhje me incidentin, përpara se të vendosë për takimin me Putinin, i cili është pritur të adresojë një sërë çështjesh, nga kontrolli i armëve deri te konfliktet në Siri dhe Ukrainë.
"Kjo do të jetë përcaktuese. Ndoshta nuk do të zhvilloj takimin. Nuk më pëlqen ai agresion. Nuk e dua fare atë agresion", tha Trumpi për gazetën "Washington Post".
Ka qenë e planifikuar që Trumpi të takojë Putinin në margjina të samitit G-20, i cili i zhvillon punimet në Buenos Aires të Argjentinës, të premten dhe të shtunën.
Komentet e tij vijnë pasi një gjykatë ruse urdhëroi që 12 nga 24 marinarët ukrainas, që u kapën nga forcat ruse, të mbahen në paraburgim për dy muaj.
Rusia ka thënë se Ukraina e ka provokuar përplasjen detare në "ujërat e saj territoriale" pranë Krimesë - gadishull që Moska e ka aneksuar ilegalisht nga Ukraina në mars të vitit 2014.
Presidenti i Ukrainës, Poroshenko, paralajmëroi se konflikti kërcënon të shndërrohet në "luftë të shkallës së plotë". "Nuk dua që dikush të mendojë se ky është një argëtim dhe lojë. Ukraina është nën kërcënimin e një lufte të plotë me Federatën Ruse", tha Poroshenko në një intervistë për televizionin kombëtar të Ukrainës.
"Numri i njësive ruse që janë pozicionuar përgjatë gjithë kufirit tonë, është rritur në mënyrë dramatike", tha Poroshenko.
Të hënën, Poroshenko mori miratimin e Parlamentit të Ukrainës për të shpallur gjendje lufte në disa pjesë të vendit, që konsiderohen të cenueshme nga Rusia, nisur nga sot.
Përleshja midis forcave ruse dhe ukrainase në ujërat pranë Krimesë ishte e para në atë zonë pas më shumë se katër vjetësh luftë midis Kievit dhe separatistëve pro-rusë në Ukrainën Lindore, ku kanë mbetur të vrarë më shumë se 10.300 njerëz.
Ajo ka pasuar disa muaj të tensioneve në rritje për ujërat në dhe përreth ngushticës Kërç, e cila tani mund të kalohet me një urë që lidh Rusinë me Krimenë. Ngushtica është rruga e vetme për anijet që udhëtojnë midis Detit të Zi dhe Detit Azov, ku Ukraina ka disa porte.
Udhëheqësit e Bashkimit Evropian thanë se po shqyrtojnë sanksione të reja ndaj Rusisë për bllokimin e paligjshëm të qasjes në Detin Azov në fundjavë dhe për shkak të kundërshtimit të thirrjeve për lirimin e detarëve ukrainas.
Karin Kneissl, ministre e Jashtme e Austrisë, vendit që mban aktualisht presidencën e BE-së, tha se blloku do t'i shqyrtojë sanksionet muajin e ardhshëm.

# Kina drejt Spanjës dhe Portugalisë si aleatë në një Evropë mosbesuese



PEKIN, 28 NËNTOR- Në mes të një lufte tregtare me ShBA-në, Kina kërkon t'i forcojë lidhjet e saj me Spanjën dhe Portugalinë, dy partnerë të kuptueshëm ndërkohë që vendet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian përpiqen t'i kufizojnë investimet kineze.
Presidenti kinez, Xi Jinpong zhvilloi të mërkurën një vizitë zyrtare në Madrid para se të shkojë në Portugali më 4 dhe 5 dhjetor.
"Kjo është një manovër gjeopolitike për t'i mbajtur marrëdhëniet në një çast të komplikuar për Kinën", shpjegon Angel Saz Carranza, drejtor i Qendrës spanjolle të Gjeopolitikës dhe Sipërmarrjes ESADEGeo.
SHBA-ja ka goditur tashmë 250 miliardë dollarë produkte kineze me taksa doganore dhe kërcënon se do të taksojë edhe 267 miliardë dollarë importet e tjera nëse nuk gjendet asnjë marrëveshje me Pekinin.
Në dhjetor, shtetet anëtare të BE-së do të shprehen mbi një dispozitiv të kontrollimit të investimeve të huaja, mbi të gjitha ato kineze, për të mbrojtur sektorët kyçe si energjia.
"Ky është çasti i deklaratave publike për t'u përpjekur që të zbutet opinioni evropian", shtoi Angel Saz Carranza.

## Presidenti ukrainas cakton datën e zgjedhjeve presidenciale



KIEV, 28 NËNTOR - Ukraina ka caktuar datën e zgjedhjeve presidenciale më 31 mars të vitit 2019.
Një rezolutë e caktimit të datës së zgjedhjeve u nënshkrua nga kryetari i Parlamentit ukrainas, Andriy Parubiy më 28 nëntor.
Rezoluta erdhi pas zotimit të presidentit Petro Poroshenko se shpallja e gjendjes së luftës për 30 ditë në 10 rajone, nuk nënkupton shtyrjen e zgjedhjeve.
Ukraina ka shpallur gjendje lufte në rajonet që kufizohen me Rusinë, pasi Rusia të dielën kishte rrethuar tri anije luftarake me brigadën e saj afër ujërave të Krimesë.
Kritikët kanë spekuluar se Poroshenko, që gjendet para një beteje të ashpër për t'u rizgjedhur president, mund të shtynte mbajtjen e zgjedhjeve.

# Kim Kardashiani zbulon avionin privat, një Boeing 747



Kim Kardashian dhe bashkëshorti i saj Kanye West kanë publikuar në "Instagram" avionin e tyre privat, një Boeing 747. Avioni ka një hapësirë për 660 pasagjerë. Ylli i televizioneve është mburrur në mediat sociale se ajo dhe Kanye e kanë të gjithin për vete. Kjo ka shkaktuar polemika në internet, pasi fansat u kthyen kundër çiftit duke i kritikuar. "Nuk mund ta besoj se Kimi dhe Kanye kanë një avion 747, të gjithin për vete", shkruanin fansat.

# Martohet Miguel



Migueli dhe e dashura e tij Nazanin Mandi janë martuar. Çifti u kurorëzua javën që lamë pas në Simi Valley në Kalifornia. Miguel dhe Nazanin morën me qira pronën për të gjithë javën dhe mbajtën ceremoninë jashtë. "Nivele të reja dhe kujtime të paharrueshme të ndara me miqtë dhe familjen më të afërt. Dashuri dhe mirënjohje për këdo që e bëri ditën tonë të veçantë dhe vërtet të paharrueshme", ka shkruar Miguel në "Instagram".



# Fejohet modeluesja e njohur e 'Victoria's Secret'

Josephine Skriver është fejuar me Alexander DeLeon. "Unë i thashë po. Jam fejuar", ka shkruar në "Instagram" modeluesja e 'Victoria's Secret'. Ajo ka treguar se ishte një natë e ftohtë e nëntorit. "Alex më shëtiti nëpër rrugët e Finlandës për t'i parë dritat. Kur ai u ul në gjunjë dhe më kërkoi që të isha përgjithmonë me të. Nuk kam qenë kurrë më e sigurt për ndonjë gjë në jetën time. Përralla ime është bërë e vërtetë. Shpirti im binjak. Miku më i mirë. Dashuria e jetës sime. Pra, sigurisht ishin një milion po", ka shkruar Skriver.



# Justin Timberlake shtyn edhe një koncert, shkak kordat zanore



Për shkak të problemeve me kordat zanore, Justin Timberlake ka shtyrë koncertin e tij "Man of the Woods", që ishte paraparë të mbahej në Staples Center në Los Angeles, më 27 nëntor. Timberlake është përballur me këtë problem shëndetësor gjatë gjithë muajit të kaluar, duke anuluar dhe shtyrë disa koncerte, njërin më 24 tetor në Nju Jork, më 28 tetor në Buffalo dhe dy koncerte të tjera në Tacoma, më 11 dhe 12 nëntor.

E jashtëzakonshme

# Kapen 50 skelete njerëzish në një tren



Të paktën 50 skelete njerëzish janë gjetur brenda një treni në stacionin hekurudhor Chapra në lagjen Saran të Bihar. Mashinisti që po drejtonte trenin Balia-Sealdah Express është arrestuar nga policia. Policia dyshon se skeletet po dërgoheshin nga Balia në Uttar Pradesh, ku do të kontrabandoheshin në Kinë përmes Butanit.

FOTO E DITES



Në të gjitha trojet shqiptare është festuar 28 Nëntori, Dita e Flamurit

E rrallë

# E zuri gjumi në kabinë, piloti lë pas destinacionin



Një pilot është vënë nën hetim, pasi e zuri gjumi në kabinën e një avioni komercial dhe e kaloi destinacionin e tij, një ishull australian 46 kilometra. Piloti, emri i të cilit nuk është bërë i ditur, ishte i vetmi person në bordin e avionit me dy motorë, dhe e kishte vënë atë nën drejtimin e pilotit automatik gjatë fluturimit.

## BARSOLETA E DITËS



**Një djalë kishte lënë takim me një bionde dhe, teksa po i jepte Ferrarit, i thotë:**
**- E dashur, dua të them diçka të rëndësishme. Unë jam i martuar.**
**- Idiot, më trembe! Mendova se Ferrari nuk ishte i yti.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### "ALPHA" 3D,



Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

**Vetem gjate vikendit në ora 14:00**

Në ora 16:00

### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"



Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
**Regjia:** David Kerr

Në ora 18:00

### "NIGHT SCHOOL"



Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
**Regjia:** Malcolm D. Lee

Në ora 20:00

### "SIBERIA",



Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
**Regjia:** Matthew Ross

Në ora 22:00

### "VENOM" 3D,



Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Nëse sot nuk e keni ditën shumë të ngarkuar, mund të merrni kohë boll për t'iu përkushtuar pasioneve tuaja.



**DEMI**
Keni marrë përsipër më shumë gjëra nga sa mund të përballoni. Do t'ju nevojitet t'i ndani mirë objektivat tuaja parësore.



**BINJAKËT**
Dikush ju ka besuar një sekret sot dhe me këtë gjë ka provuar që ju konsideron vërtet mik. Do të bëni të pamundurën për ta ndihmuar.



**GAFORRJA**
Nuk mund t'i përgjithësoni gjërat sot. Çdo situatë duhet vlerësuar për atë që i takon, jo duke u bashkuar me situata të tjera të ngjashme.



**LUANI**
Mundohuni të realizoni në praktikë çdo ide që keni menduar kohët e fundit. Kështu do të kuptoni nëse ia vlen vërtet mundimi.



**VIRGJËRESHA**
Keni kërkuar kohë për të bërë disa zgjedhje për ju dhe për partnerin. Në momentin e duhur është mirë t'i komunikoni zgjedhjet tuaja.



**PESHORJA**
Edhe pse jeni përqendruar në disa projekte paralelisht, do të arrini t'i realizoni. Nuk ka asgjë të keqe të kërkoni më të mirën nga vetja.



**AKREPI**
Keni pasur shumë energji negative kohët e fundit dhe i keni shprehur me njerëzit që ju kanë qëndruar pranë.



**SHIGJETARI**
Edhe pse i jeni përkushtuar shumë një personi të caktuar, nuk keni marrë asgjë në shkëmbim. Bëni mirë të ripozicionoheni.



**BRICJAPI**
Është mirë t'i shembni muret që janë krijuar mes jush dhe një pjesëtari tjetër të familjes. Toleranca është një zgjidhje mjaft e mirë.



**UJORI**
Sot mundohuni të jeni më produktive dhe mos krijoni polemika të kota. Idetë që keni, kërkojnë suport financiar.



**PESHQIT**
Ndonjëherë pa e vënë re merrni një sjellje distante gati snob. Është mirë ta moderoni mënyrën e të sjellit.

# Gashi: MKRS-ja, një nga institucionet kryesore për parandalimin e dukurive negative për të rinjtë

PRISHTINË, 28 NËNTOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporti, Kujtim Gashi, ka marrë pjesë në konferencën "Toleranca - siguria njerëzore e të rinjve në Kosovë" e organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).
Qëllimi i kësaj konference ishte reflektimi mbi të arriturat e vitit 2018 nga ky sektor për përkrahjen dhe fuqizimin e të rinjve në fushën e sigurisë njerëzore si dhe rolin e OSBE-së në bashkëpunimin e mëtutjeshëm me MKRS-në në fushën e sigurisë për të rinj. Me këtë rast, ministri Kujtim Gashi ka thënë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbetet edhe më tutje një nga institucionet kryesore për parandalimin e dukurive negative për të rinjtë, përfshirë këtu edhe luftimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. "Për realizimin e suksesshëm të misionit tonë në fushën e sigurisë në këtë vit kemi mbështetur 28 organizata në fushën e sigurisë, përfshirë këtu: parandalimin e trafikimit, delikuencës, kriminalitetit, dhunës ndëretnike, promovimin e tolerancës dhe mirëkuptimit, si dhe janë mbështetur 19 qendra dhe organizata rinore në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm, pesë prej të cilave në partneritet me OSBE-në", ka thënë ministri Gashi.
Ai ka thënë se si ministri, pos mbështetjes financiare që po u japin organizatave rinore e qendrave rinore, janë në finalizim edhe të strategjisë së re, e cila do të jetë e përkushtuar në mekanizmat e rinisë. "Jam këtu për ta konfirmuar mbështetjen si ministër, si MKRS, që asnjë i ri të mos jetë i prekur nga këto tema që do të trajtohen sot", ka thënë Gashi. Ai ka inkurajuar të gjithë që të kontribuojnë sa më shumë në avancimin e mbrojtjes dhe promovimit të një mjedisi sa më të mirë dhe më të sigurt për të rinjtë.
Ndërkaq Xhevat Bajrami, drejtor i Departamentit të Rinisë në MKRS, ka thënë se këtë vit kanë mbështetur disa OJQ, për të pasur qasje në ruajtjen e ambientit ku jetojmë.
Ganimete Gërboci nga Departamenti i Sigurisë Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka thënë se siguria është një ndër shtyllat kryesore që e garantojnë kushtetutshmërinë e shtetit. "Krahas boshteve të tjera kryesore të një shteti, siguria mbetet shtylla kurrizore e ekzistencës fizike dhe garantimit të kushtetutshmërisë. Çelësi i suksesit për ta rritur nivelin e sigurisë në vend është komunikimi midis institucioneve në nivel qendror dhe lokal. Bashkëpunimi ndërmjet ministrive është rritur dukshëm. MKRS-ja ka pas vetes të gjithë rininë. Ne jemi të gatshëm të ndihmojmë çdo ministri sepse qëllimet tona janë të njëjta", ka thënë Gërboci.



# Yllka R. Imeri ka botuar librin 'Rep Music Language'




PRISHTINË, 28 NËNTOR (ER) - Më 19 nëntor të këtij viti është botuar libri "Rep Music Language" i autores Yllka R. Imeri nga shtëpia botuese "Lambert" në Gjermani.
Libri është studim gjuhësor në fushën e fonetikës.
Libri "Rep Music Language" është në gjuhën angleze. Objekt studimi i këtij libri është gjuha e repistëve. Imeri është asistente e rregullt në Fakultetin e Filologjisë në Degën e Gjuhës Shqipe, në Universitetin e Gjakovës. Për autoren ky është libri i saj i dytë. Autorja ka theksuar se studimi ka për qëllim: transkriptimin e këngëve, aktin e veçantë të komunikimit, ndikimin e gjuhëve të huaja në tekstet e kënduara.
E veçanta e këtij punimi është studimi i trokut dhe morave që i përkasin fushës fonetike. Studimi i autores Imeri trajton mjetet gjuhësore të përdorura për tekstet e këtyre këngëve. Në kuadër të këtij studimi trajtohen elementet fonetike dhe fonologjike, përfshirë elementet mbisegmentore, por edhe tërësinë e varieteteve të shfrytëzuara.

## Ribotohet libri "Jetë në rrugëtim" i autorit Haki Morina

PRISHTINË, 28 NËNTOR (ER) - Pas interesimit të madh të lexuesve, është ribotuar libri "Jetë në rrugëtim" i autorit Haki Morina. Përmes librit "Jetë në rrugëtim" autori Haki Morina, me anë të rrëfimit të rrjedhshëm, të strukturuar e të begatuar, ia ka dalë me sukses që përmes dramës personale t'u sjellë lexuesve të të gjitha gjeneratave, posaçërisht gjeneratës së re, një akt të rëndësishëm të dramës së përgjithshme të Kosovës, përkatësisht të rrugëtimit të lirisë dhe mbijetesës së saj.
Ky libër e pasuron dhe e bën më të begatshme letërsinë memoaristike shqiptare të Kosovës që për tematikë e ka burgosjen politike.






# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | |
|---|---|---|
| MALMO - GENK | 2 | |
| CHELSEA - PAOK SALONIKA | 1 | |
| EINT.FRANKFURT - MARSEILLE | 3+ | |

# '89-shi eliminoi Llapin nga Kupa

Gara e kupës në futboll pritet të jetë shumë interesante, pasi fituesi i saj merr pjesë në garat e Evropa Ligës. Deri tash janë eliminuar tri skuadra të rëndësishme: Llapi, Drenica dhe Vushtrria

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



PRISHTINË, 28 NËNTOR - KF Trepça '89 e ka shkaktuar befasinë më të madhe në 1/16 e finales së Digitalb Kupës së Kosovës në futboll, pasi e ka eliminuar skuadrën e Llapit. Skuadra nga Mitrovica, edhe përkundër faktit se në kampionat po tregon formë jo të mirë, në garën e Kupës ka shkëlqyer ndaj skuadrës së Llapit, ku ka fituar me rezultat 2-0. Epërsia e parë e vendësve erdhi në minutën e 18-të, kur Djibril Diwara me një gjuajtje me kokë e mposhti portierin Afrim Ademi për rezultatin 1-0. Llapi u mundua të rikthehet në lojë, por pa sukses e, në anën tjetër, vendësit e shënuan edhe golin e dytë në minutat shtesë. Autor i golit ishte Muharrem Jashari, i cili realizoi një gol të bukur për rezultatin final 2-0. "Nuk ishim në përformancën tonë më të mirë. Kemi bërë shumë gabime dhe kemi pasur probleme në të gjitha repartet. U munduam të ndryshonim diçka në pjesën e dytë të lojës, provuam gjithçka, por nuk ia arritëm. Kur nuk arrin të realizosh në portën e zbrazët, kjo tregon se çfarë dite kemi pasur sot. Duke pasur parasysh që objektivi i klubit ka qenë fitimi i kupës, tani na mbetet të luftojmë vetëm për titullin kampion. Nëse nuk arrijmë të shpallemi kampionë, atëherë objektivat e klubit nuk do të realizohen", ka thënë Bekim Shotani, trajner i Llapit.

Skuadra tjetër nga Mitrovica, Trepça, nuk arriti t'i rezistojë Feronikelit që shënoi fitore me rezultat 1-2. Kapiteni Lapidar Lladrovci në minutën e 22-të e kaloi në epërsi skuadrën nga Drenasi, kurse pesë minuta para fundit të pjesës së parë Astrit Fazliu e dyfishoi erepsinë e "Niklit". Shtatë minuta para fundit, Trepça iu gëzua golit të parë, të cilin e realizoi futbollisti Lapidar Lladrovci në portën e skuadrës se tij.

Ndërkaq kampionia aktuale e Kosovës, Drita, e mposhti Vitinë pas penalltive me rezultat 3-1, pasi koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan me rezultat 1-1. Të shtunën kualifikimin e ka arritur edhe skuadra e Prishtinës që e mposhti Drenicën nga Skenderaj me rezultat 5-4, pas penalltive. Kryeqytetasit dhe kuqezinjtë e Drenicës kohën e rregullt dhe vazhdimet i mbyllen me rezultat të barabartë 0-0. Kika ka shkaktuar një tjetër befasi në këtë xhiro të Kupës, pasi e ka mposhtur skuadrën aktualisht më të mirë në Ligën e Parë, Kika - Vushtrria (2-0).

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Vitia - Drita | 1-1 |
| | (1-3 pas penalltive) |
| Trepça '89 - Llapi | 2-0 |
| Trepça - Feronikeli | 1-2 |
| Lugu i Baranit - Liria | 0-11 |
| Vllaznia (P) - Besa | 1-2 |
| Ferizaj - Vllazëria (Zh) | 6-2 |
| Fushë Kosova - Onix | 3-2 |
| KEK-u - Flamurtari | 0-1 |
| Bashkimi - Vëllaznimi | 0-4 |
| Sharri - Gjilani | 2-2 |
| | (2-6 pas vazhdimeve) |
| Istogu - Ramiz Sadiku | 3-1 |
| Drenasi - Ballkani | 0-1 |
| Dukagjini - Arbëria | 3-1 |
| Kika - Vushtrria | 2-0 |
| Drenica - Prishtina | 0-0 |
| | (pas penalltive 4-5) |

## SHKURT

### Sot përurohet fusha e futbollit në Skenderaj

Sot (e enjte) në Skenderaj do të bëhet përurimi i fushës së ndërtuar të futbollit me bari artificial, e cila është bërë me investim të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). Në përurimin e fushës në Skenderaj do të marrin pjesë drejtuesit e FFK-së, kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi dhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari.

### Struga, fituese e "Kupës Pavarësia"

Skuadra e Strugës është fitues e "Kupës Pavarësia", pasi është treguar skuadër më e suksesshme se tri skuadrat e tjera pjesëmarrëse: Skënderbeu, Ontranti dhe 2 Korriku. Në ndeshjen e parë gjysmëfinale Otranti e mposhti 2 Korrikun pas penalltive me rezultat 6-5. Në ndeshjen e dytë gjysmëfinale Struga ka mposhtur Skënderbeun (1-0). Në finale Struga e mposhti ekipin e Ontrantit 1-0 dhe në këtë mënyrë e fitoi "Kupën Pavarësia". Ekipi "Fair Play" u vlerësua 2 Korriku, ndërsa çmimi i lojtarit më të mirë i takoi Nijaz Lenës nga skuadra e Strugës.

### Lenjani zgjedh De Biasin para Panuccit

Ermir Lenjani është një prej futbollistëve më në formë që ka Shqipëria aktualisht, teksa me Sionin ka arritur të shënojë dhe dhurojë asistime në mënyrë të rregullt. Në një intervistë për "Shqipëria.ch", Lenjani e ka zgjedhur Gianni De Biasin para Christian Panuccit. "Me De Biasin kam kaluar shumë kohë dhe kemi arritur sukses historik. De Biasi më ka besuar shumë, më ka vendosur gjithmonë në fushë dhe natyrisht ia kam shpërblyer. Do ta zgjidhja De Biasin", ka thënë Lenjani.

### FBK-ja më 12-13 dhjetor pjesëmarrëse në short për kampionatet evropiane

Sekretarja e përgjithshme e Federatës së Basketbollit e Kosovës (FBK), Elvira Dushku dhe drejtori i përfaqësueseve të Kosovës, Granit Rugova, më 12 dhe 13 dhjetor do të qëndrojnë në Beograd, ku do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për FIBA Kampionatet Evropiane të kategorive të reja në të dyja konkurrencat, kur edhe përfaqësueset e Kosovës do t'i marrin vesh emrat e kundërshtarëve të tyre.
FBK-ja për herë të parë e ka paraqitur për të garuar Përfaqësuesen U20 në konkurrencën e femrave dhe tashmë janë gjithsej 6 përfaqësuese që do të marrin pjesë vitin e ardhshëm në FIBA Kampionate Evropiane, Divizione B (U16, U18, 20, meshkuj dhe femra). Gjithashtu, do të bëhet edhe hedhja e shortit për FIBA Eurobasket 2019 në konkurrencën e femrave që do të organizohet në Serbi dhe Letoni, si dhe për raundin e tretë të parakualifikimeve për "Eurobasket 2021" në konkurrencën e meshkujve.

## KOK-u nderohet me çmimin për arritje

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Komiteti Olimpik i Kosovës është nderuar në Asamblenë Gjenerale të ANOC-ut që po mbahet në Tokyo të Japonisë. KOK-u ka pranuar çmimin "Breakthrough Award" (Çmimi për Arritje) për paraqitjen e parë në Lojërat Olimpike Dimërore "PyeongChang 2018". LOD u mbajtën në PyeongChang të Koresë së Jugut, kurse Kosova debutoi me skitarin Albin Tahiri. Çmimin presidentit të KOK-ut, Besim Hasani, ia dorëzoi presidenti i Komitetit Olimpik të Evropës, Janez Kocijančiq. Për çmimin e marrë presidenti Hasani dhe sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, u uruan nga presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach dhe ish-presidenti i ANOC-ut, Sheikh Al Fahad Al Sabah, që tashmë ka dhënë dorëheqje nga posti i tij. Kujtojmë që një çmim të tillë nga ANOC-u, KOK-u e kishte pranuar edhe në vitin 2016, bashkë me medalisten e artë në Lojërat Olimpike "RIO 2016", Majlinda Kelmendi.



## FShF-ja i beson Panuccit

